

## Përdorimi i bimëve mbuluese në prodhimin e bimëve mjekësore dhe aromatike

### Përfitimet dhe zbatimi

Mbjellja e bimëve mbuluese është një praktikë e rëndësishme në bujqësinë organike. Duke prodhuar biomasë shtesë midis dy kulturave kryesore, ato përmirësojnë pjellorinë, strukturën dhe shëndetin e tokës dhe parandalojnë erozionin. Mbjellja e bimëve mbuluese është në përputhje me parimet e bujqësisë organike të cilat synojnë ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu është një nga veprimet kryesore që fermerët mund të ndërmarrin për t'i bërë tokat e tyre më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Ky udhëzues ofron një pasqyrë të përgjithshme të përfitimeve dhe sfidave të kultivimit të bimëve mbuluese dhe jep udhëzime praktike mbi përzgjedhjen e këtyre bimëve.



### Përfitimet e përdorimit të bimëve mbuluese

Bimët mbuluese mund të ofrojnë përfitime të shumta në qarkullimin bimor gjatë kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA).



#### Furnizimi me lëndë ushqyese për bimët kryesore

- Bimët mbuluese pasurojnë shtresën sipërfaqësore të tokës duke thithur lëndë ushqyese për bimët nga shtresat më të thella të tokës.
- Bimët mbuluese si bishtajoret pasurojnë tokën me azot të marr nga atmosfera, kështu zvogëlojnë nevojën për plehra komerciale.
- Lëngjet (sekrecioni) që lirohet nga rrënjët ushqejnë organizmat e tokës, nxisin aktivitetin mikrobiologjik në zonën e rrënjëve. Kjo përmirëson pH-in e tokës dhe rrit sasinë e lëndëve ushqyese.
- Furnizimi vjetor i përgjithshëm me azot (N) nga bimët mbuluese sillet nga 20 deri në 200 kg N për ha. Përderisa bimët jo-bishtajoret sigurojnë 2,5 kg N për ha për ton masë të freskët, bishtajoret sigurojnë rreth 4 kg N për ha. Sa më e gjatë të jetë kohëzgjatja e rritjes së bishtajoreve, aq më shumë azot fiksohet-sigurohet në tokë.



#### Parandalimi i humbjeve të lëndëve ushqyese

Në tokat e ngrohta në vjeshtë, lënda organike mineralizohet me shpejtësi, duke rritur nivelet e azotit (nitratit) të tretshëm në ujë. Nëse në tokë nuk ka bimë që thithin azotin (nëse toka lihet e zhveshur gjatë dimrit), ky azot humbet nëpërmjet shpëlarjes, duke ndotur ujërat nëntokësore dhe rrugët ujore. Bimët mbuluese të mbjella në kohë, veçanërisht bimët jo-bishtajore, mund të mbajnë pjesën më të madhe të azotit të tretshëm.



#### Rritja e pjellorisë së tokës

- Lënda organike e tokës rrit depërtimin e ujit dhe përmirëson aftësinë e tokës për të ruajtur dhe liruar vazhdimisht lëndë ushqyese dhe ujë, duke krijuar kushte më të mira të rritjes dhe duke zvogëluar stresin e bimëve gjatë periudhave të thatësirës.
- Bimët mbuluese me strukturë 'drunore' mund të rrisin nivelet e lëndës organike në tokë.